**SEASIDE ENTERTAINMENT SH.P.K**
**NJËSIA BASHKIAKE NR.2, RRUGA DERVISH HIMA, PALLATI AMBASADOR 3, KATI 4, APARTAMENTI NR. 31, TIRANË**
**NUIS: M11401027K**

---

**VENDIM**
**I**
**ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME**

Sot, më 17.11. 2021, në orën 10.30, në selinë e Shoqërisë Seaside Entertainment sh.p.k. (më tej referuar si "Shoqëria"), mbahet mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë me të pranishë:

**Green Coast Sh.p.k.**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, organizuar sipas ligjeve të Shqipërisë, me seli në Njësia Bashkiake nr.2, Rruga Dervish Hima, Pallati Ambasador 3, Kati 4, Apartamenti nr. 31, Tiranë, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS: L41329038D, e cila zotëron 1 kute te Shoqerise Seaside Entertainment qe përfaqëson 100 % (njëqind përqind) te kapitalit te Shoqerise (Oraku i Vetëm), ne kete asamble e përfaqësuar rregullisht nga Z. Latif Drenofci shtetas shqiptar, Iindur me 28.04.1970, ne Tirane madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i leternjoftimit me nr. 035681762, dhe me numer personal H00428169D, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar, në cilësinë e Administratorit.
Z. Drenofci i cili merr përsipër të kryesojë mbledhjen, fton znj. Rozana Kodrari, e cila pranon, të kryejë funksionin e sekretarit.
Kryetari i Asamblesë pasi deklaron vullnetin e Ortakut të Vetëm për të vendosur për çështjet në rendin e ditës, pavarësisht mungesës së njoftimit për thirrjen e asamblesë, e deklaron Asamblenë e Përgjithshme të Shoqërisë të mbledhur rregullisht bazuar në paragrafin e dyte të nenit 83 të Ligjit n. 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe të aftë për të marrë vendime të vlefshme mbi rendin e ditës si në vijim:

**<u>RENDI I DITËS</u>**

**I. MIRATIMI I ZMADHIMIT TË KAPITALIT TË SHOQËRISË**

* * * * *

Kryetari i Asamblesë në lidhje me pikën e parë dhe të dytë në Rend të Ditës parashtron se për qëllime operacionale Ortaku i Vetëm ka vendosur te kontriboje në para në shoqëri në një vlerë prej 500,000 LEK (pesëqind mije leke). Për sa më sipër është e nevojshme që vlera e përgjithshme e kapitalit të reflektohet dhe në Statutin e Shoqërisë.

Pas një vlerësimi të kujdesshëm të çështjes së Rendit të Ditës, Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë:

**VENDOSI:**

**A.** Të miratojnë zmadhimin e kapitalit të Shoqërisë nëpërmjet kontributit në para në vlerën prej 500,000 LEK (pesëqind mije lekë).
**B.** Zmadhimi i kapitalit është i shlyer plotësisht nga Ortaku i Vetëm nëpërmjet derdhjes bankare.
**C.** Si rezultat i miratimit të Zmadhimit të Kapitalit sipas pikave (A) dhe (B), kapitali i Shoqërisë, nga 1,000 Lekë (një mijë lekë) do të bëhet **501,000 LEK (pesëqind e nje milje leke).**

Për sa më sipër, autorizohet Administratori i Shoqërisë, të kryejë të gjitha aplikimet e nevojshme me qëllim regjistrimin e këtij vendimi pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit personalisht ose nëpërmjet autorizimit të tjerëve.

*****

Meqenëse nuk pati asnjë çështje tjetër për të diskutuar, Kryetari e deklaron mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë të mbyllur në orën 10.30.

Ky proçesverbal i Asamblesë së Ortakut te Vetëm te "Seaside Entertainment" sh.p.k mbahet në përputhje me nenin 90 të Ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "*Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare*", i ndryshuar.

**ASAMBLE E PËRGJITHSHME**
**SEASIDE ENTERTAINMENT SH.P.K**
**ORTAKU I VETEM**
**GREEN COAST SH.P.K.**
**KRYETAR**

**LATIF DRENOFCI**

Green Coast
L41329038D

**SEKRETARE**

**ROZANA KODRARI**